

Stereotipet dhe paragjykimet në Big Brother VIP

Nga Anisa Krasniqi

(Shqyrtuar dhe mbikqyrur nga: Prof. Rrapo Zguri)

Punimi është realizuar si pjesë e projektit “Edukimi për Median dhe Informacionin në universitetet shqiptare: Nga pilotimi në zbatim,” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

1. HYRJE

Reality Show është bërë një format i përhapur dhe ndikues i kulturës moderne popullore. Zhanri zë fill në vitet 1940 me ardhjen e shfaqjeve të lojërave, por vetëm në fillim të viteve 2000 ai pati një shpërthim të konsiderueshëm në popullaritet me shfaqje si *Survivor*, *Big Brother* dhe *Amerikan Idol*. Këto shfaqje të hershme hodhën bazat për peisazhin e larmishëm dhe shpesh të diskutueshëm të televizionit të realitetit që shohim sot. Rritja e *reality show* mund t'i atribuohet disa faktorëve, duke përfshirë kostot më të ulëta të prodhimit, joshjen e dramës pa skenar dhe magjepsjen e publikut me jetën personale të të tjerëve. Megjithatë, zhanri është përballur me kritika për portretizimin e situatave të ekzagjeruara dhe dëmin e mundshëm që mund t'u shkaktojë pjesëmarrësve, por edhe publikut.

Ky punim përqendrohet tek analiza e spektaklit televiziv *Big Brother VIP Albania* që shfaqet në Top Chanel duke u fokusuar posaçërisht në hulumtimin e stereotipeve dhe paragjytimeve të përdorura në këtë *reality show*.

Shfaqja e parë e *Big Brother* në botë u transmetua në 1999 në Holandë dhe menjëherë pas Holandës, filloi transmetimi në vendet e tjera evropiane dhe SHBA. Në Shqipëri emisioni filloi së transmetuari më 24 shkurt 2008 në Top Channel dhe ka transmetuar nëntë sezona deri më tani.

Për të mbledhur fakte dhe të dhëna, është zhvilluar një kërkim në dy sezonet e fundit të *Big Brother VIP*. Janë ndjekur katër metoda kërkimore për këtë qëllim:

- 1.Kërkimi në videot e emisioneve *prime time* të këtyre programeve;
- 2.Kërkimi në videot e plota ditore të këtyre programeve, për disa ditë specifike ku rezulton të ketë pasur raste të bujshme të stereotipeve dhe paragjytimeve;
- 3.Kërkim online në Google përmes fjalëkyçeve;
- 4.Evidentimi i disa rasteve studimore tipike

Videot ku është bërë kërkimi janë gjetur në arkivat online të këtyre emisioneve dhe në YouTube.

Nga ana tjetër është bërë përpjekja që stereotipet dhe paragjykimet të grupohen sipas kategorive për të nxjerrë në pah specifikat e secilës kategori, shkallën e përhapjes, efektin dhe ndikimin tek publiku i gjerë.

2. TERMINOLOGJI DHE HISTORI

Nëse do t'i referoheshim kuptimit të konceptit të *reality show*, do ta gjenim të shpjeguar si një program televiziv në të cilin njerëzit e zakonshëm filmohen vazhdimisht, program ky i krijuar për të qenë argëtues por jo informues.¹ Pra, është një lloj programi televiziv që synon të tregojë se si njerëzit e zakonshëm sillen në jetën e përditshme, ose në situata, shpesh të krijuara nga editimi selektiv, të cilat synojnë të përfaqësojnë jetën e përditshme.

Ndërsa kur flasim për *stereotip*, automatikisht kemi të bëjmë me një mendim specifik për individët bazuar vetëm në përkatësinë e tyre në një grup, pavarësisht nga karakteristikat e tyre individuale. Stereotipet mund të jenë pozitive ose negative dhe kur mbi-përgjithësohen, zbatohen

¹ REALITY SHOW | English meaning - Cambridge Dictionary

për të gjithë anëtarët e një grupi. Për shembull, stereotipi model i pakicës së amerikanëve aziatikë si shumë inteligjentë, të zellshëm dhe të mirë në matematikë mund të jetë i dëmshëm profesionalisht dhe akademikisht. (Gordon W. Allport, 1954, f. 124) Këto besime janë të mbi-përgjithësuara për të gjithë anëtarët e grupit, edhe pse shumë nga anëtarët individualë të grupit në fakt mund të mos jenë të tillë akademikisht dhe profesionalisht.

Një shembull tjetër i një stereotipi të njohur përfshin besimet rreth dallimeve racore midis atletëve. Atletët meshkuj me ngjyrë shpesh besohet se janë më atletikë, por më pak inteligjentë, sesa homologët e tyre meshkuj të bardhë. Këto besime vazhdojnë pavarësisht nga një sërë shembujsh të profilit të lartë për të kundërtën. Fatkeqësisht, besime të tilla shpesh ndikojnë në mënyrën se si këta atletë trajtohen nga të tjerët dhe se si ata e shohin veten dhe aftësitë e tyre. Pavarësisht nëse je apo jo dakord me një stereotip, përmbajtja e tij është përgjithësisht e njohur brenda një kulture të caktuar.

Një rrugë tjetër që çon në diskriminim është edhe *paragjykimi*. Vetë fjala "paragjykim" nënkupton që ne po shprehim një opinion ose vlerësim pa i peshuar siç duhet provat, pra para se të vlerësojmë në mënyrën e duhur. Në mënyrë tipike, ky mendim rezulton i pasaktë. Kjo ka të metën e përhapjes dhe çon në përgjithësim. Psikologët socialë janë veçanërisht të interesuar për efektet e paragjykimit. Por çfarë nënkuptojmë saktësisht me paragjykim? Psikologu i shquar Gordon Allport jep perkufizimin me të njohur të paragjykimit: "Paragjykimi është një armiqësi e bazuar në përgjithësim të gabuara dhe jofleksibile; ajo mund të ndihet dhe artikullohet; mund t'i drejtohet një grupi ose një anëtar të atij grupi". (Gordon W. Allport, 1954, f. 124)

Trajektorja historike që të çon në reality TV ka një shtrirje më të gjerë se sa referenca e saj në programet faktike dhe dëshmon se programi ka ndryshuar sepse edhe vetë televizioni ka pësuar një ndryshim të tillë. Funkzioni i televizionit si shërbim publik që u krijua që në fillimet e mediumit në Britani ka përfshirë synimin për të bashkuar një komb dhe kulturat e tij përbërëse, klasat shoqërore dhe rajonet duke i treguar audiencës se si jetojnë njerëzit e tjerë. (Dovey, J., 2001)

Kjo rezultoi në imperativin për të regjistruar jetën e të tjerëve, por jo thjesht për të dokumentuar vendet, profesionet, grupet shoqërore dhe klasat, por edhe për të analizuar perceptimet e tyre karakteristike për veten dhe për të ndërhyrë në situatat tyre, ose vendosen në situata të krijuara në mënyrë eksplicite nga regjisori ose agjencia e prodhimit, dhe më pas i nënshtrohet presionit, manipulimit ose ftesës për të ndërvepruar me situatën dhe ekipin e prodhimit. Komponenti i dytë kyç nga këto tradita që mund të evidentohet në një *reality show* është qëllimi i programit. (Dovey, J., 2001)

Si traditat franceze ashtu edhe ato britanike apo amerikane theksojnë momentet e krizës ose transformimit, duke kërkuar të lejojnë audiencën të reflektojë mbi forcat që ndikojnë tek individët dhe se si ata reagojnë ndaj këtyre forcave. Ata synojnë gjithashtu t'i mundësojnë vetë subjektit dokumentar që të ketë një hapësirë në të cilën të flasë për transformimin personal. (Barnfield, G., 2002)

Në televizionin britanik, kjo autonomi për subjektin e programit u zhvillua në serinë e BBC-së Video Nation, e realizuar mes viteve 1995 dhe 2000. Prodhuesit e tij ishin të prirur të sillnin në televizion trashëgiminë nga vitet 1930 të projektit "Mass Observation", i cili mblodhi komente dhe rrëfime personale të një numri të madh njerëzish që mbanin ditarë të jetës së tyre të përditshme dhe komentonin ngjarjet shoqërore dhe politike të kohës. (Corner, J., 1995)

Video Diaries e vazhdoi këtë interes për njerëzit e zakonshëm dhe konceptin e mbledhjes së raporteve nga një gamë e gjerë klasash shoqërore dhe rajone të Britanisë. Por, në vend që të jepte një pasqyrë të qëndrimeve sociale dhe politike, ai u fokusua në detajet e jetës së përditshme të njerëzve, punën dhe kohën e lirë, shqetësimet dhe qëndrimet e tyre.

Në njëzet vitet e fundit, në Video Diaries dhe shumë programe të tjera që shfaqin njerëz të zakonshëm, formati i ditarit video është prezantuar si një komponent i dokumentarit konvencional (ku subjektet e programit dhe gjithashtu krijuesit e tij mund të prodhojnë regjistrime të tilla edhe në formate si Big Brother dhe dhoma e tij e rrëfimit).

Pjesëmarrësit flasin privatisht para kamerës për veten e tyre, duke e ditur se ky fjalim privat do të bëhet publik kur të transmetohet programi. Ajo që njerëzit thonë para kamerës shpesh bazohet në ndjenjat e tyre për veten dhe se si ata ndryshojnë me kalimin e kohës si pjesë e një përvoje mësimore. Ndërsa disa pasazhe të emisionit formohen për të ndërtuar një mjegullnajë mes asaj që është publike dhe asaj që duhet të mbetet private. (Corner, J., 1995)

Në vendet në tranzicion, si Shqipëria kjo megashfaqje sociale, përveç ushtrimit të ndikimit "edukativ e arsimor" e ka shtrirë efektin edhe në sferat e tjera socializuese. Themi socializuese, edhe për shkak se institucionet përkatëse socializuese (familja, shkolla, rrethi social) ishin dhe mbeten ende në rimëkëmbje dhe ringritje e sipër. Që nënkupton një kolizion përkatës me trendet sociokulturore të kohës dhe me zhvillimet sociopolitike, të etnopsikologjisë dhe mentalitetit të shoqërisë shqiptare. Është edhe një lloj paradigme ilustruese e kohës në të cilën po jetojmë, e që nga shumica e sociologëve e politologëve identifikohet si globalizëm. (Maloku, Fadil; 2023)

Sociologu e filozofi i njohur Right Mils, ka diku një thënie, ku deklarohet se; "Individualizmi i tepruar, si "produkt" i kapitalizmit neoliberal ka gjasa dhe prirje reale të prodhojë personalitete të deformuara...!" Shqiptarët, në mungesë të përvojës së ndërtimit të kupolës së kornizës kapitaliste, aq më pak asaj neoliberale, duket që janë duke shijuar tmerrësisht shpejt e pakompromis si "produktet" ashtu edhe pasojat që është duke prodhuar ky tip i ri i turbokapitalizmit kulturor neoliberal. (Maloku, Fadil; 2023)

Pra, ata po shpërthejnë në një individualizëm ekstrem duke i rrezikuar kështu si raportet e ngushta interpersonale ashtu edhe ato familjare. Interpersonale, sepse ata tranzicioni i zuri të papërgatitur (për shkak të ish "infrastrukturës" së njëmendësisë komuniste) dhe të pa konsoliduar (për shkak të "arratisjes" së "trurit" intelektual nga vendi). Tani "kujdestaria sociale shtetërore", duket që ende po prodhon deformitete e sjellje të atilla deviante që po i vënë në pikëpyetje si riprodhimin e thjeshtë sociokulturor ashtu edhe atë socioekonomik! (Maloku, Fadil; 2023)

Pjesëmarrësit përzgjidhen jo pa qëllim, për faktin se para së gjithash është ndërtuar një lloj skene se si ky personazh do të reagojë ndaj situatave të ndryshme, flasim këtu gjithmonë për ato situata të cilat do të kenë një dinamikë edhe në opinion. Së dyti, një tjetër element që nxjerr jashtë natyrës së saj realitetin, është dhe procesi i editimit selektiv, në të cilin manipulohet jo vetëm koha (Perseritur gjithmonë që këto programe janë koherente), por paraqesin edhe linja të shtrembëruara të konteksteve të ngjarjeve për të krijuar tension. Kështu realiteti bie pre e karremit mediatik. (Maloku, Fadil; 2023)

Pikërisht në këtë korpus deformimesh ajo që në fund merr audiencia është një vorbull e madhe antivlerash, paragjykimesh dhe stereotipesh.

3. ANALIZË E STEREOTIPEVE DHE PARAGJYKIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË TYRE

3.1 Stereotipet dhe paragjykimet gjinore

Në Big Brother dallojmë disa lloje dhe burime të stereotipeve dhe paragjykimeve. Për një qasje më praktike, do të marrim në shqyrtim dy edicionet e fundit të Big Brother Vip Albania, nga ku fokusi do të ngrihet në analizën videove të *prime time*. Si fillim, në objektin tonë të parë analitik do të vendosim datën 3 Janar 2023, (Big Brother Albania Vip 2). Gjatë një diskutimi mes Amos Zaharias dhe Olta Gixharit, që duket se po flasin për Luizin evidentojmë këto ngjyresa:

- Amos Zaharia : *"Të flejë princeshë Luiza duke gërrhitur si kafshë dhe ne të tjerët të rrimë pa gjumë"*²

Në këtë pasazh shohim se Amosi e vesh sjelljen e Luizit me një paragjykim gjinor, pra me një princeshë. Ky etiketim gjatë videos në prime time nuk mori vëmendjen e duhur duke rritur në këtë mënyrë gjasën që Amos ta shtrijë deri në stereotipizim këtë veshje paragjykimi. Automatikisht paragjykime të këtij lloji, mbajnë larg mundësinë e barazisë duke theksuar se princeshat (në këtë rast gratë e vajzat) flenë në një mënyrë të tillë që pjesa tjetër refuzon të jetë e përfshirë.

Në vijim, në një tjetër episod, në atë të katërt, 23 Janar, 2024, Egla i drejtohet Gazit:

- Egla Ceno: *"Je burrë pa këllqe"*³

Kjo frazë automatikisht sipas Eglës, mund të kategorizohet si një paragjykim gjinor sepse përdor një stereotip të përgjithshëm dhe negativ në lidhje me karakteristikat e një personi, bazuar ndoshta në fuqinë ose guximin e tij. Ajo sugjeron që personi i adresuar është i dobët, pa kurajë ose pa aftësinë për të vepruar siç pritet nga një "burrë" sipas normave shoqërore. Në këtë kontekst, është një vlerësim i pabazuar dhe një paragjykim i lidhur me një ide të ngurtë të "çfarë duhet të jetë një burrë".

Në këtë episod, evidentojmë edhe një paragjykim gjinor, kur Ledjona referohet kundrejt Ilnisës:

- Ledjona Xheladinaj: *"Kapet me femrat se me meshkujt nuk ja mban"*⁴

Ledjona në këtë rast, nënkupton se personi tjetër nën trysinë e paragjykit ka aftësi më të mira në komunikimin me femrat se sa me meshkujt, duke e lidhur këtë me një aspekt të përgjithshëm, pra një dobësi apo paaftësi të saj për të marrë përsipër situata me meshkuj.

Ndërsa në episodin e pestë, evidentojmë sërish stereotip gjinor, i cili ngrihet nga Dea ku shpreh se:

- Dea Vieri: *"Burrat janë të gjithë tradhëtarë"*⁵

Ky afirmim i përgjithshëm dhe i pabazuar që përfshin të gjithë burrat në një kategori negative, duke i etiketuar ata si tradhëtarë, nënkupton se të gjithë individët e një grupi (në këtë rast, burrat)

² https://youtu.be/bNhqKJ-Rpsq?si=tf_hrAaDCbNoSCCj

³ <https://youtu.be/7TrShBHqaFQ?si=WHDhvsCgeTRM8aEz>

⁴ <https://youtu.be/7TrShBHqaFQ?si=WHDhvsCgeTRM8aEz>

⁵ <https://youtu.be/EC5YVnrQXcI?si=d6ByWJKSblH4KHJQ>

ndajnë një karakteristikë të caktuar, pavarësisht nga dallimet individuale dhe nga fakti se ky nuk është një vlerësim objektiv apo i bazuar në prova. Kjo frazë forcon stereotipet negative për burrat dhe e trajton çdo burrë si tradhtar pa marrë parasysh rrethanat specifike.

Në episodin e 6-të të datës 30 Janar, 2024, Romeo u drejtohet banorëve të tjerë, gjatë lojës së javës:

- Romeo Veshaj: "*Burra pa sedër*"⁶

Kur dy grupet marrin pjesë në "lojën" e javës për një burim të caktuar vlere që zhvillon produksioni, grupi që fiton nuk e ndan shpërblimin me atë që shpallet si humbës, dhe në këtë linjë grupi kundërshtar shikohet si rrezik, kërcënim duke u zhvilluar kështu stereotipi. Në këtë rast kemi zhvillimin e stereotipit gjinor nga Romeo, kundrejt banorëve të tjerë.

3.2 Stereotipet dhe paragjykimet sociale dhe karakteriale

Në një nga episodet i qasemi tashmë një lloj stereotipi social (i veçimit), i cili ngrihet nga Mariana dhe Dionisi kundrejt Gordanës:

- Mariana Kondi dhe Dionis Biba: "*Hajde rri me ne se ka më shumë audiencë dhe famë*"⁷

Në këtë linjë dallojmë disa qasje negative që vijnë nga ky lloj stereotipi:

- Inkurajimi i vlerësimit sipas famës dhe audiencës;
- Rritja e presionit për të arritur famë;
- Krijimi i dallimeve mes individëve;
- Vlerësimi sipërfaqësor i marrëdhënieve;
- Ndikimi negativ në vetëvlerësim.

Në një tjetër përmbledhje ditore, arrijmë të konstatojmë një tjetër stereotip social, nga ku Valeri shprehet kundrejt Dionisit për banorët se:

- Valer Kolnikaj: "*Nuk dinë akoma se çfarë është arti*"⁸

Cili është impakti që krijohet dhe në çfarë piketash ngrihet?

- Nënvlërësimi i shijes dhe përceptimit individual;
- Kufizimi i kuptimit të artit;
- Diskreditimi i mundësive të zhvillimit të artit;
- Stigmatizimi i përceptimit të artit nga publiku i gjerë, etj.

⁶ https://youtu.be/3_tFJ09LxaY?si=I5RIWtcuVzOj1ADD

⁷ <https://www.instagram.com/reel/C8CHgwnoBQG/?igsh=d3E5MGVvMzZ2ZmE4>

⁸ <https://www.instagram.com/reel/C8BwYZ6ofD1/?igsh=Mm55cHI0NmI3bmc4>

Më tej, Meri në dhomën e rrëfimit, teksa flet dhe përshkruan sjelljen e Ledjonës, i referohet strategjisë së saj tekstualisht si më poshtë:

- Meri Shehu: "*Shkoni mbaroni ndonjë shkollë të hajrit, pastaj hajde flisni me mua*"⁹

Ky stereotip formohet si kategorizim, dhe në këtë pikë duke qenë perceptues, Meri i grupon banorët e tjerë në një përgjithësim, duke mos menduar për secilin prej tyre në mënyrë të veçantë, pra ajo në mënyrë direkte vë në përplasje të vazhdueshme dy mentalitete duke krijuar mes tyre këtë rrjet komunikimi me keto karakteristika. Ky proces njihet ndryshe dhe si kategorizim social, ose përgjithësimi mbi aftësitë e një grupi. (Zick, A., T. F., & Wagner, U. 2008).

Së dyti, evidentojmë paragjykimin social ose karakterial që Olta i bën Zhaklinës, kur i drejtohet se në sytë e saj ajo duket një "njeri i vogël" dhe "pa shtyllë kurrizore", pra pa identitet. Në mënyrë nënçmuese dhe poshtëruese figura e Zhaklinës në impaktin publik paraqitet në këto variante, pa qenë të informuar se paragjykesja nuk e njeh personalisht personin që vë përballë paragjykimin, dhe se mungesa e argumenteve në debatet me të është mjaft e dukshme, duke i zëvendësuar në këtë mënyrë me ngjyresa të tilla diskriminuese, duke e minimizuar dhe humbur identitetin e saj.¹⁰

3.3 Stereotipet dhe paragjykimet moshore

Në Big Brother VIP nuk kanë munguar as stereotipet dhe paragjykimet moshore. Në një qasje të Oltës në raportin e saj me Gentin, ajo shprehet kështu në dhomën e rrëfimit: (14 janar 2023)

- Olta Gixhari: "*Nuk mund të flas me të, është si kalama, i ngel hatri*"¹¹

Për rrjedhojë, ky lloj paragjykimi i kategorizuar në atë moshor, mbështetet kryesisht në idenë se afatet kronologjike të dikujt ose i kufizojnë ose i lejojnë ata të kryejnë një veprim specifik apo të arrijnë në një përfundim, e në këtë rast i referohet pikërisht paaftësisë së Gentit, i cili është i kufizuar nga ana emocionale për të përballuar një diskutim apo debat me personazhin në fjalë.

E gjithë kjo bëhet pa marrë parasysh nevojën për të marrë në arsyetim përvojat dhe zhvillimin psikologjik ose emocional.²⁸ Po në këtë episod, kemi sërish prezent një tjetër paragjykim, atë intelektual, nga ku Olta i referohet Gentit gjatë një debati me të me përgjithësimin "je shumë i trashë", duke sugjeruar se ai është i pafuqishëm për të kuptuar ose për të menduar në mënyrë të thellë dhe të qartë. Në mënyrë direkte ky etiketim e bën atë (Gentin) të ndihet inferior intelektualisht, dhe shpesh ka të bëjë me stigmatizimin e individëve që mund të kenë vështirësi të kuptuarit ose të shprehurit.¹²

Përsëri evidentojmë një paragjykim moshor, gjatë një debati mes Rikes dhe Ilnisës, nga ku kjo e fundit përgjithësohet si një grua që i përket një moshe të madhe dhe se nuk ka aftësinë për t'u përshtatur me tendencat e reja apo moshat e reja:

- Rike Roçi: "*I kanë rënë puplat*"¹³

⁹ <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>

¹⁰ <https://youtu.be/bNhqKJ-Rpsg?si=AyUB5NPuOLobREbI>

¹¹ <https://youtu.be/F21wyFGiapY?si=8JZsB01Lf9pLfine>

¹² <https://youtu.be/F21wyFGiapY?si=y0wYLR0kjSjhxOSF>

¹³ <https://youtu.be/EC5YVnrQXcI?si=d6ByWJKSbIH4KHJQ>

Shprehur në mënyrë metaforike, leksema “puplat”, evidenton pikërisht rënien apo humbjen e aftësisë për tu përshtatur.

Evidentojmë një tjetër paragjykim i cili është njëherazi edhe gjinor por dhe moshor, që në një rast Tea bën kundrejt banorëve meshkuj në shtëpi, gjatë një diskutimi me Luizin:

- Tea Trifoni: *"Më burrë jam unë që jam nga Lushnja dhe jam 23 vjeç"*¹⁴

Në këtë qasje Tea ngre si potencial një qëndrim më të fortë dhe më të saktë të meshkujve në raport me femrat, pra duke zbehur eventualisht edhe barazinë mes tyre, por nga tjetër duke theksuar ndryshimin moshor, ajo interpreton ose më saktë ngre në mënyrë hipotetike se ka një aftësi më të madhe njohëse në raport me grupmoshat e tjera, hipotezë kjo e cila nuk është ngritur në asnjë lloj argumenti, pasi ajo nuk ka një informacion të përgjithshëm ose jo lidhur me secilin prej tyre, që i bën pjesë të këtij kategorizimi.

Objekti i dytë i marrë në shqyrtim është Big Brother Vip Albania 3, i cili ngrihet në disa episode. Në këtë rast kemi të tjerë personazhe, por rrjeta e komunikimit ka të njëjtë strukturë paragjykimesh dhe steriotipesh. Në episodin e dytë të këtij edicioni, evidentojmë gjatë një debati mes Eglës dhe Meritonit, një paragjykim moshor, më specifikisht ajo i drejtohet shpesh me etiketimin "djalosh", "kalama" ose kur përshkruan sjelljen e tij e justifikon me "ego prej djaloshi".¹⁵

Në këtë pikë, Egla në mënyrë të vetëdijshme e vendos Meritonin në një ndarje breznie dhe aftësie për të kuptuar "intelektin" e jashtëzakonshme të një jo-djaloshi apo personi tjetër jashtë këtij etiketimi, duke e shfaqur këtë personazh si të papjekur para audiencës.

3.4. Stereotipet dhe paragjykimet fetare

Situata e radhës, i referohet një tjetër debati, i cili konstatohet mes Rikes dhe Merit, ku kësaj të fundit i vihet në dyshim besimi:

- Rike Roçi: *"Ti nuk beson në Zot se je fallxhore"*¹⁶

Ky lloj paragjykimi kategorizohet si një paragjykim fetar. Ky lloj paragjykimi sulmon personin dhe besimet e tij në vend që të trajtojë argumentet e tij. Pra, akuzohet personazhi në fjalë (Meri) për mungesë besimi në Zot dhe bëhet etiketimi i saj si "fallxhore".

Në një tjetër episod, në atë të tretë, të datës 20 Janar, 2024, evidentojmë një tjetër paragjykim që lidhet me karakteristika apo elementë të tjerë të sjelljes, që e bëjnë Rozën, të shprehet për Merin se:

- Roza Lati: *"Ajo është psikopate, lunatike"*¹⁷

Më pas, debati pasohet nga Meri kundrejt Rozës, pasazh në të cilin dallojmë njëkohësisht një paragjykim intelektual dhe një steriotip, nga ku ajo zbeh ose zvogëlon vlerat e saj duke e shfaqur si një njeri të paaftë.

¹⁴ <https://youtu.be/F21wyFGiapY?si=y0wYLR0kjSjhxOSF>

¹⁵ <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>


¹⁶ <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>

¹⁷ <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>

- Meri Shehu: " Më je dukur si xhongler, njeri pa vlerë" ¹⁸

Nga ana tjetër me leksemën "xhongler" do të vendosej më specifikisht dhe ngjyresa e stereotipizimit, duke theksuar dhe mënyrën tallëse të sjelljes së saj duke e bërë atë një objekt qesharak dhe të pavlerë.

Në një pamje të përgjithshme, duke ju referuar kërkimit tonë sasior të paraqitur në grafikun më poshtë, shohim se përdorim më të gjerë kanë paragjykimet moshore, gjinore, paragjykimet me bazë sociale apo intelekti, ndërsa paragjykimet me bazë fetare janë më pak të përdorshme në raport me sa thamë më sipër. Ndërkohë që stereotipet më të përdorshme janë ato gjinore, nacionale dhe të veçimit, nga ku këto të fundit zënë një terren më të madh në raport me dy të tjerat, duke u pasuar nga ato nacionale dhe më pas ato gjinore.



Grafiku nr. 1: Hapësira që zënë kategoritë e stereotipeve në Big Brother VIP

PËRFUNDIME

Këto stereotipe mediatike shfaqen si mjete që zëvendësojnë mungesën e argumentit apo njohjes së një qasjeje të caktuar. Duke paraqitur një katalizator mediatik të këtyre sjelljeve, qëndrimeve apo besimeve negative, siç është Big Brother VIP, shohim se paragjykimet janë të përhapura gjerësisht, si pjesë e një kulture, pavarësisht nxitjes së faktorit mediatik ose jo. Këto modele nxisin veprime dhe gjykime diskriminuese.

¹⁸ <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>

Stereotipizimi i fenomeneve ndodh në ato kushte kur informacioni për këtë fenomen është në mungesë. Pra, është një para-model i gatshëm, të cilin ti e merr dhe thua se ky model ka egzistuar, e ka menduar dikush tjetër dhe mua më përshtatet. Çfarë do të thotë kjo? Duke qenë se stereotipet kanë lindur në teatrin e mesjetës, në skenë u vunë karaktere të ndryshme që personifikonin problematika të ndryshme sociale, dhe si rrjedhojë e këtyre problematikave lindën edhe etiketimet. Në bashkëkohësi ne i qasemi këtyre stereotipeve të mesjetës pa patur një informacion rreth këtyre fenomeneve, por duke i marrë si modele të gatshme, të krijuara nga të tjerë dhe duke mos i vënë asnjëherë në diskutim.

I gjithë ky konglomerat zinxhir ka një ndikim negativ dhe në edukimin që pretendohet se përcillet në audiencën e të rinjve, të cilët automatikisht shmangin mundësinë për ta njohur tjetrin, apo fenomenin ose situatën, për të formuar në këtë mënyrë stereotipizimin. Kjo e fundit, stigmatizimi, karikaturizmi i tjetrit, shkojnë krahas me denigrimin, inferiorizimin dhe diskriminimin. Dhe media po bëhet platformë “ideale” ku stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimet përhapen me një lehtësi të madhe. Problemet e etikës, edukimit dhe dezinformimit çojnë në një brez të dhunshëm, të cilët zhvillojnë sekuenca kriminale dhe tëhuajsuere ndaj njeri tjetrit.

Një prej qasjeve të rëndësishme për të kuptuar në mënyrë inteligjente dhe koherente se si funksionin i gjithë ky rrjet stereotipesh dhe paragjykimesh është duke njohur së pari terrenin e vendosjes së Reality Show. Njohja dhe studimi i saj, do t'i jepte mundësinë secilit të njihte mirë terrenin mediatic, si përdoret dhe deformohet narrativa, si i qasen realitetit dhe se cilat mjete përdoren për të krijuar këto devijime.

Pra, nëpërmjet kësaj njohjeje, ne arrijmë të njohim mirë disa elementë:

- Manipulimi i realitetit në televizion është bërë një praktikë e përhapur, ku skenat e shkruara dhe historitë janë një dukuri e zakonshme në reality shoë.
- Duke hequr disa ndërveprime ose duke manipuluar sekuencën e ngjarjeve, krijuesit e shfaqjes mund të ndërtojnë një rrëfim që përputhet me historinë e tyre të dëshiruar, shpesh në kurriz të përvojave të vërteta të pjesëmarrësve.
- Është thelbësore që të shqyrtohen në mënyrë kritike praktikatat mashtruese të përdorura në televizionin e realitetit për të kuptuar ndikimin e këtyre manipulimeve dhe dëmin që ato shkaktojnë si te pjesëmarrësit ashtu edhe te shikuesit.
- Redaktimi selektiv është një praktikë e zakonshme në televizionin e realitetit, që përdoret për të manipuluar narrativën dhe për të krijuar tregime të bujshme. Kjo teknikë përfshin pamje për të nxjerrë në pah disa sjellje ose ndërveprime, shpesh jashtë kontekstit, për t'u përshtatur një narrative të paracaktuar. Duke lënë mënjanë informacionin thelbësor ose duke manipuluar sekuencën e ngjarjeve, prodhuesit e realitetit televiziv mund të krijojnë dramë, konflikte dhe tensione ku mund të mos ketë pasur fillimisht.
- Mbikëqyrja e vazhdueshme, izolimi nga njerëzit e dashur dhe manipulimi i emocioneve nga prodhuesit mund të çojë në ndjenja paranoje, mosbesimi dhe paqëndrueshmëri emocionale.

- Shqyrtimi i mënyrave në të cilat ai shtrembëron realitetin dhe përjetëson stereotipe të dëmshme, çon në përfundimin se sfondi i televizionit të realitetit vendos themelet për krijimin apo çimentimin e mëvonshëm të procesit të stereotipizimit dhe të paragjykit.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

- Barnfield, G., 'From Direct Cinema to car wreck video: Reality TV and the crisis of content', in D. Cummings (ed.), *Reality TV: How Real is Real?* (London: Hodder and Stoughton, 2002), 47-66.)
- Bignell, J. (2005), *Big brother: reality TV in the twenty-first century*. Palgrave Macmillan
- Cambridge Dictionary, *Reality show*
- Corner, J., *The Art of Record: A Critical Introduction to Documentary*, Manchester, Manchester University Press. 1996
- Dovey, J., 'Reality TV' in G. Creeber (ed.), *The Television Genre Book* (London: BFI, 2001), 134-7
- Gordon W. Allport, *The Nature of Prejudice*. Addison-Wesley, f. 124, London, 1954
- Luku, Elvin, (2016) *Talk show në peizazhin televiziv shqiptar*, faqe 115-120
- Maloku, Fadil; (2023), *Big Brother VIP Albania- një megashfaqje për konzumerizmin (evident) dhe hedonizmin (e dëshiruar)!* Link: <https://nacionale.com/opinion/big-brother-vip-albania-nje-megashfaqje-per-konzumerizmin-evident-dhe-hedonizmin-e-deshiruar>
- Zick, A., T. F., & Wagner, U. (2008). *Ethnic prejudice and discrimina in Europe*. *Journal of Social Issues*, 233-251

Burime në internet:

- <https://centaur.reading.ac.uk/23194/1/Chap1BignellRealityTV.pdf>
- <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/reality-show>
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Big_Brother_Albania
- <https://youtu.be/EC5YVnrQXcI?si=d6ByWJKSbIH4KHJQ>
- <https://www.instagram.com/reel/C8GGUoHIk0/?igsh=MTdqaHAzZhsYzJqNA==>
- <https://www.instagram.com/reel/C8FkwJFIQ3/?igsh=angzNzZub2U0Y2Fk>
- <https://www.instagram.com/reel/C8C7UbrIWT2/?igsh=MTc0aGQzenV6dnZ6MQ==>

- <https://www.instagram.com/reel/C8CHgwnoBQG/?igsh=d3E5MGVvMzZ2ZmE4>
- <https://www.instagram.com/reel/C8BwYZ6ofD1/?igsh=Mm55cHI0NmI3bmc4>
- <https://youtu.be/7TrShBHqaFQ?si=WHDhvsCgeTRM8aEz>
- <https://youtu.be/EC5YVnrQXci?si=d6ByWJKSblH4KHJQ>
- https://youtu.be/3_tFJ09LxaY?si=I5RIWtcuVzOj1ADD
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZf>
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>
- <https://youtu.be/7TrShBHqaFQ?si=WHDhvsCgeTRM8aEz>
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>
- <https://youtu.be/i-iD8hYSiws?si=z2eRWODNTj4ytZfR>